

# “BERBERI I SEVILJES” nën petkun e Marubit



Regjisori francez Eric Vigner

“Berberi i Sevilies”, komedia e famshme e Beaumarchais, do të ngjitet në skenën e Teatrit Kombëtar në prill të këtij viti. Për të vënë në skenë këtë komedi ka ardhur për herë të parë të punojë në Teatrin Kombëtar një regjisor francez. Prej dy javësh ngjijtë shkallët e zhurmshme të Teatrit Kombëtar për t’u marrë me aktorët në provat në tavolinë. Eric Vigner, i cili aktualisht është drejtor i teatrit rajonal të qytetit (Lerien) në Francë, duket se i ka vënë vërtet në punë aktorët. Një metodë e ndryshme pune, një konceptim regjisorial ku pjesë e të cilës janë

dhe skenografia dhe kostumet e veçanta, pra gjithçka ndryshe... Në krah i qëndron Vasjan Lami si as/regjisor (i ndihmuar dhe nga njohuria e gjuhës frënge) si dhe një student i Akademisë së Arteve, Olti Bakalli, ura lidhëse mes tij dhe aktorëve (përsa i përket gjuhës). Regjisori Vigner flet për “Kult”, se si erdhi bashkëpunimi me Teatrin Kombëtar, përgjedhjen e kastit të aktorëve në të cilin bëjnë pjesë emra si Luiza Xhuvani, Roland Trebicka... dhe përse pikërisht “Berberin e Sevilies”...

Monda Shima

## Përgjedhja e aktorëve dhe bashkëpunimi me Teatrin Kombëtar...

Eric Vigne: Kohë më parë takova drejtorin e Teatrit Kombëtar, Armando Bora, i cili më ftoi të vija një pjesë në Teatrin Kombëtar. Para disa kohësh, herën e parë që erdha në Shqipëri pashë disa shfaqje, pashë lojën e aktorëve dhe nisur nga kjo vendosa të bashkëpunoj me këtë apo atë aktor. Në dëshirën time ishte të vija në skenë “Martesën e Figaros”, por për shkak se është shumë e rëndë si shfaqje ka shumë personazhe, ka shumë muzikë, balet etj, vendosa të bëj diçka më të thjeshtë dhe zgjodha “Berberin e Sevilies”, duke qenë se ishte një bashkëpunim shqiptaro-francez. Doja një pjesë klasike franceze që të vihej në skenë nga një regjisor francez në bashkëpunim me aktorët shqiptarë.

## Puna deri tani...

Është shumë interesante, aktorët po punojnë shumë mirë, megjithëse kemi vetëm dy javë që po merrem me provat, kemi dhe një muaj tjetër kohë akoma si dhe shumë prova gjer në ditën e premierës me datë 19 prill. Janë mënyra të ndryshme pune që jemi mësuar si unë si aktorët, duhet të vëzhgojmë njëri-tjetrin, për ta është një metodë tjetër pune, por them se kjo është një eksperiencë e bukur, por për më shumë nëse janë apo jo të kënaqur aktorët, duhet të pyesësh ata...

## “Berberi i Sevilies” nga Beaumarchais, më e hershme se opera e Rosinit...

Shpresoj shumë që të arrijmë diçka vërtet të mirë por dua të theksoj faktin që bëhet fjalë për komedinë “Berberi i Sevilies” të Beaumarchais dhe jo opera e Rosinit. Vepra e Beaumarchais është publikuar në 1763, ndërkohë që opera e Rosinit ka dalë vetëm në 1816. Duhet patur parasysh që pjesa që unë do të vë në skenë është e folur, e folur e kënduar dhe e kënduar.

## Sfida, natën e premierës më 19 prill...

Më 19 prill do të shohim se nëse ky bashkëpunim ka qenë vërtet i frytshëm, nuk mund ta them akoma... Çdo herë është e ndryshme. Eksperiencia më e fundit që ishte shumë e ndryshme nga kjo, ishte vënia në skenë e “Borgjezit fisnik” të Molerit në Teatrin Kombëtar të Seulit në Korenë e Jugut. Përvoja ishte shumë e ndryshme duke qenë se bëhej fjalë për Azi, ishin mënyra të tjera pune, ndërkohë që mendoj se Shqipëria duke qenë se bën pjesë në Evropën Lindore ka metoda pak të përafërta pune me atë të Rusisë, me Stanislavskin (teoricieni i mjeshtrësisë së aktorit). Ndërkohë që regjia franceze në këto 20 vitet e fundit ka ecur shumë përpara, por mendoj që çdo përvojë është interesante...

## BERBERI I SEVILJES

Teatri Kombëtar

Gjinia: Komedi

Autor: Pierre Beaumarchais

Regjia &amp; skenografia: Eric Vigner

As/regjisor: Vasjan Lami

Kostumografia: Anila Zajmi

Muzika: Fatos Qerimi

Interpretojnë: Luiza Xhuvani (Rozina), Roland Trebicka (Konti Almaviva), Helidon Fino (Figaro), Neritan Liçaj (Bartolo), Mito Bitraku (Don Bazilio)

Mbështetur nga Ambasada Franceze

Mbështetur nga Ambasada Franceze

Mbështetur nga Ambasada Franceze


Mbështetur nga Ambasada Franceze

S'afërmi

Komedia “Berberi i Sevilies” e Beaumarchais vjen me një vizion modern, elegant. Para publikut shqiptar do të vijë me kostumet e frymëzuara nga albumi i fotografit të shquar Marubi, të cilat do të vijnë në një kontrast bardhë e zi që do të simbolizojnë edhe idenë e regjisorit mbi këtë vepër. Ideja kryesore e kësaj vepre është himnizimi dhe sakrificat që duhet të bëjë njeriu për të fituar dhe triumfuar në emër të dashurisë. Dhe natyrisht lufta midis së bardhës dhe të zezës, midis dashurisë dhe errësirës do të mbarojë me fundin e shfaqjes me triumfin e trëndafilit të bardhë, që në këtë rast është njëkohësisht paqe dhe dashuri.

## Vasjan Lami: Bashkëpunimi me Vigner, një eksperiencë e vlefshme...

Është një eksperiencë që vërtet i kishte munguar teatrit. Kemi patur shansin të punojmë me regjisorin rumun shumë të suksesshëm, Mihalesku, Milçinin maqedonas dhe ai shumë i mirë. Kemi punuar dhe me Agim Sopin, një regjisor kosovar dhe ai shumë i suksesshëm dhe kjo me Vigner është një nga eksperiencat e pakta në Teatrin Kombëtar që vjen një regjisor i huaj, akoma më shumë francez dhe shumë i suksesshëm. Mjafton fakti që ka vënë katër pjesë në “Comedi français” që është nder i madh të hysh në Teatrin Kombëtar të Francës, në Paris, pra mbahet nga regjisorët e rinj të suksesshëm (dhe pse ai nuk është i ri, po shkon gati 50 vjeç). Vigner po sjell një metodë të re pune, krejt e ndryshme nga e jona në sensin teknik dhe viziv të shfaqjes, pra është një formë tjetër. Aktorët tanë janë mësuar me një metodë tjetër, ndryshe, por është një eksperiencë e vyer dhe ndjehet që aktorët janë shumë entuziastë, shumë të kënaqur. Ndërkohë janë shumë kërkues ndaj vetes, sepse kjo metodë pune që është dhe ndryshe ata i ka sugjestionuar dhe vijnë gjithmonë të përgatitur, janë të interesuar për të bërë gjëra të reja, për ta kuptuar sa më mirë regjisorin dhe mendoj që do të jetë një nga bashkëpunimet më të frytshme në sensin profesional dhe si shkëmbim eksperiencë, se si marrim një eksperiencë të re në Teatrin Kombëtar.



BAKALLI, VIGNER, LAMI



NERITAN LIÇA



BITRAKU, BAKALLI, VIGNER, LAMI